



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt. 30.11.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK "LURIMI" SHPK

ADRESA: Diber L DRITA

Procedura e prokurimit/lotit: **"Shërbim konsulence"**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-54455-12-20-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë" në pronësi të Bashkisë Tiranë".**

Publikimet e mëparshme (*njoftim i kontrates*): Buletini Nr. 176 datë 27 Dhjetor 2022

Publikimet e mëparshme (*njoftim paraprak fituesi*): Buletini Nr. 96 datë 30 Nëntor 2023 *

* *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

- **Operatori ekonomik "LURIMI" shpk me NUIS J68403912U**
- **Operatori ekonomik "DEJA" shpk me NUIS K37509969C**

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerat përkatëse të ofruara.

• **Operatori ekonomik "LURIMI" shpk me NUIS J68403912U**
Vlera e ofertës pa tvsh = **4.529.000 (katër milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë**
dhe totali i pikëve të marra **96.16 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) pike.**

- **Operatori ekonomik "DEJA" shpk me NUIS K37509969C**

Vlera e ofertës pa tvsh = **4.846.000 (katër milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë** dhe totali i pikëve të marra **91.16 (nëntëdhjetë e një pikë gjashtëmbëdhjetë) pike.**

Lista e operatorëve ekonomikë të s'kualifikuar:

S'kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Diava Consulting“ sh.p.k me NUIS K67617903E

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “Diava Consulting“ sh.p.k ka dorëzuar shtojcën 12 “**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**” nga ku rezulton se

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e

tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

a) çmimet ;

b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

nuk është klikuar një nga alternativat e përcaktuara sipas pikës 6 gërma (a dhe b) duke mos deklaruar mënyrën se si është bërë ofertimi pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje me asnjë konkurrent tjetër apo ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi? Në këtë mënyrë pa u proceduar me klikimin si më sipërcituar AK nuk e merr informacionin e nevojshëm lidhur me këtë seksion të shtojces 12.

KVO citon se shtojca 12 “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik.

Në vijim të vlerësimit të formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojces 12 ne seksionin B “Deklarata për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” vihet re se operatori

ekonomik “Diava Consulting” shpk ka deklaruar vetëm tre punonjës nga stafi i kërkuar në kriterin 2.3.2 ndërkohë që nga AK janë kërkuar përkatësisht 5 punonjës sipas specialiteteve të përcaktuara në kriterin si më sipërcituar. Për sa kohë në këtë seksion përcaktohet qartë se operatori duhet të deklarojë se ka/disponon punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës nëse kërkohen duhet ti listojë të gjithë stafin e nevojshëm në deklaratën e tij.

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Për këtë shkak shtojca 12 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Diava Consulting“ sh.p.k , nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën e kriterëve të përgjithshme të miratuar nga APP, për arsyet sa më sipër cituar.

Në rregullat e prokurimit, DST , Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”Seksioni 1, Hartimi i ofertës, në piken 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kriterëve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , neni 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Çekani” shpk me NUIS J77617616R

S’kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

Autoriteti Kontraktor ne piken 2 pika 1 germa (b) te rubrikes “Kriteret e vecanta per kualifikim” ka kerkuar si me poshte vijon:

“Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. **Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5**;

Nga verifikimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik “Çekani” shpk Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstatoi se operatori ekonomik sa me siper cituar nuk ka paraqitur ne spe sigurimin e ofertes duke rene ndesh me percaktimin e bere ne dokumentat standarte te tenderit pika 2/1 germa (b) pjese perberese e kriterëve te veçanta per kualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik ”Xhepi” shpk me NUIS K84509202A

S’kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

Operatori ekonomik “Xhepi” shpk ka dorëzuar shtojcën 12. Në seksionin “**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**” rezulton se :

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen

e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

4. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
5. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
6. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
7. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
8. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

9. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a. **Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;**
 - b. **Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).**
10. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- e) çmimet ;
 - f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

11. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specififikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
12. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

nuk është klikuar një nga alternativat e përcaktuara sipas pikës 6 gërma (a dhe b) duke mos deklaruar mënyrën se si është bërë ofertimi pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje me asnjë konkurrent tjetër apo ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi? Në këtë mënyrë pa u proçeduar me klikimin si më sipërcituar AK nuk e merr informacionin e nevojshëm lidhur me këtë seksion të shtojces 12.

KVO citon se shtojca 12 “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik.

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Për këtë shkak shtojca 12 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Xhepi” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktura në shtojcën e kriterëve të përgjithshme të miratuar nga APP, për arsyet sa më sipër cituar.

Në rregullat e prokurimit, DST , Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”Seksioni 1, Hartimi i ofertës, në piken 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kritereve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 pjesë përbërëse e kërkesave të vecanta për kualifikim është kërkuar se:

*” Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për **shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ”*

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik “Xhepi” shpk ka paraqitur një kontrate individuale të lidhur në dt 26.03.2018 me objekt: “Shërbime lidhur me pyllëzimin e 24.3 ha sipërfaqe pyjore në objektin Mali i Krujës ngastra 18” financues i të cilës është subjekti “Antea Cement” shpk. Kjo kontratë është efektive nga data e lidhjes dt 26.03.2018 deri në dt. 31.03.2020. Në dt 13.04.2018 operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur aktin e dorëzimit Nr.1 të lëshuar nga Bashkia Krujë Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për realizimin e pyllëzimit deri në dt 13.04.2018.

Kjo kontratë vërtet i shtrin efektet deri në dt 31.03.2020 afat i cili është brenda afatit 3 vjecar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës por nuk është paraqitur asnjë vërtetim realizimi për përmbushjen me sukses të kontratës nga Bashkia Krujë në përfundim të këtij afati (dt 30.03.2020) në mënyrë që të vlerësohet nëse shërbimi i pyllëzimit ka vijuar të realizohet me sukses apo jo duke krijuar kështu një mosbindje tek AK nëse kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses apo jo. Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i mjaftueshëm për të gjykuar nëse deri në përfundim të kësaj kontrate procesi i pyllëzimit është kryer ose jo me sukses.

Në vijim për plotësimin e kriterit 2.3.1 për kontratat e ngjashme operatori ekonomik “Xhepi” shpk ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi (BOE) me operatorin ekonomik “Asper konstrukcion” shpk me anë të së cilës kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë me objekt: “Pyllëzim me akacie dhe shërbimet silvi-kulturale për tre vite” me Nr REF -42620-09-21-2022. Nga dokumentacioni i depozituar në përmbushje të këtij kriteri nuk ka asnjë informacion se kur është lidhur kjo kontratë, nuk ka informacion mbi vlerën e kontratës së lidhur në mënyrë që të gjykohet nëse plotësohet ose jo vlera e kontratës së ngjashme. Përpos këtij fakti në kriterin si më sipër cituar kërkohet *”që ofertuesit e mundshëm të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*.

Referuar sa më sipër cituar kjo kontratë afatin e ka tre vjecar pra nuk është kryer/realizuar ende si shërbim duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë sa më sipër cituar dhe në këtë mënyrë nuk mund të dimë nëse operatori ekonomik do ta realizojë ose jo me sukses kontratën. Pra në këtë rast nuk krijohet bindja nga AK se edhe kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për fazën e dytë nuk ka operatorë ekonomikë të s’kualifikuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “LURIMI” SHPK**, me adresë: Diber Burrel L DRITA, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **4.529.000 (katër milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë** pa tvsh/ totali i pikëve të marra **96.16 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) pike** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **4.846.000 (katër milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë** dhe totali i pikëve të marra **91.16 (nëntëdhjetë e një pikë gjashtëmbëdhjetë) pike**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____